

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 8944 Kol.
Nr. 1330 Rep.



KONTRATË

SHIT – BLERJE AKSIONESH

Sot, më datë 11 /10/2002, para meje Agim ROBO, Noter i Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqitën personalisht, Shitësi dhe Blerësit, të cilët më kërkuan redaktimin e kësaj Kontrate Shit – Blerje Aksionesh me termat e mëposhtme :

SHITËSI : Mirjona Maho, e bija e Nevruzit, e datëlindjes 1973, dhe banuese në adresën “Rruga e Kavajës”, Pall. 141, Sh.1, Ap. 8, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me cilësinë e ortakut të shoqërisë Tregtare “JONA” sh.p.k.

BLERËSI : Petrit Maho, Petrit Maho, i biri i Gëzimit dhe Ganimetit, i datëlindjes 1967, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë me adresë “Rruga e Kavajës”, Pall. 141, Sh.1, Ap. 8, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me cilësinë e ortakut të Shoqërisë Tregtare “JONA” sh.p.k.

OBJEKTI: Shitja e kuotave të shoqërisë “JONA” sh.p.k. në masën 50%, kuota këto të zotëruara nga Mirjon Maho, me cilësinë e shitësit dhe blerja e tyre nga Petrit Maho, me cilësinë e blerësit.

PËRMBAJTJA E KONTRATËS

Shoqëria Tregtare “JONA” sh.p.k. është rregjistruar në Rregjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me vendimin nr.14613, datë 23.04.1996. Shoqëria është themeluar me një kapital themeltar të rregjistruar prej 100.000 lekë.

Me vendimin e datës 03.10.2002 të Asamblesë së Ortakëve të kësaj shoqërie, është vendosur miratimi i shitjes së aksioneve, në masën 50% në favor të blerësit Petrit Maho.

Shitja e pjesës prej 50% të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë Tregtare “JONA” sh.p.k., sjell humbjen e së drejtës së pronësisë të ortakut të kësaj shoqërie Mrjona Maho, mbi këtë pjesë, si pasojë e këtij transaksioni shitjeje, shprehur kjo në vendimin e mësipërm të Asamblesë së Ortakut.

Shitësi, Mirjona Maho, është plotësisht dakort t'i shesë me vullnetin e saj të lirë dhe të plotë, Blerësit, Petrit Maho, vlerën prej 50% të kuotave të kapitalit themeltar. Nga ana e tij Blerësi, Petrit Maho është plotësisht dakort që të blejnë pjesën prej 50% të kuotave, pjesë takuese e kjo e Shitësit në kapitalin themeltar të shoqërisë tregtare "JONA".

MËNYRA EKALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE

Me nënshkrimin e kësaj kontrate Shitësi, Mrjona Maho, e humbet pronësinë e saj në masën prej 50% të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë "JONA" sh.a., duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi këtë pjesë. Ndërsa Blerësi, Petrit Maho, bëhet pronar i kësaj pjese në masën 50% të kuotave të kapitalit themeltar.

Shoqëria Tregtare "JONA" sh.p.k. pas realizimit të kësaj kontrate shit – blerje do të ketë si ortak të saj, me pjesëmarrje si më poshtë:

- Petrit Maho zotëron 100% të kuotave të kapitalit themeltar.

ÇMIMI I SHITJES SË KUOTAVE

Si çmim i këtij transaksioni shit – blerje të kuotave të shoqërisë tregtare "JONA" sh.p.k. do të jetë ai i vlerës nominale të një aksioni, të përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Vlera nominale e një kuote është 1000 lekë.

Sipas këtij përcaktimi Blerësi, Mirjona Maho, paguan në favor të Shitësit Petrit Maho shumën 50.000 lekë, shumë e cila është paguar jashtë kësaj zyre dhe shitësi nuk do të ketë sot dhe në të ardhmen pretendime për këtë shumë apo për çdo shumë tjetër.

DISPOZITA TË FUNDIT


Kontrata hartohet në pesë kopje të njëjta, nga të cilat një e mbajnë palët, një kopje depozitohet në Zyrën e Rregjistrimit Tregtar, një kopje depozitohet në Aktet e Shoqërisë dhe një kopje pranë Zyrës së Noterisë ku ajo u redaktua.

Termat e kontratës, pasi u redaktuan prej meje Noterit, iu bënë të njohura palëve kontraktuese, të cilat e nënshkruan atë me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, në prezencën time.

PALËT


SHITËSI
Mirjona MAHO

Mirjona Maho
MF 338 287




BLERËSIT
Petrit MAHO

Petrit Maho
M: 10
9/7



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE
T I R A N E
Nr. 4908 Rep.
Nr. 481 Kol.



KONTRATE DHURIMI KUOTE-KAPITALI

Sot me daten 21 (njëzet e një) Tetor 1999 (Nëntëdhjet e nëntë), ditën e Enjte, para meje, Notere FATIME META, e regjistruar ne Dhomen e Notereve, Tirane, me zyre ne Rr. "Durrësit", P.118, Sh.1, Ap.1, u paraqiten personalisht dhe me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate dhurimi kuotash-kapitali, ne perputhje me Nenin 761e ne vijim te K.C., si dhe me Nenin 45 e ne vijim te "Kodit Tregtar", bashkeshortët si me poshte:

DHURUES: PETRIT MAHO, i biri i Gëzimit dhe i Ganimetit, i datëlindjes 1967, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, Rr. e "Kavajës", P.141, Sh.1, Ap. 8, ortak i vetem dhe Administrator i Shoqërisë "JONA" - SH.P.K., me seli ne Tirane, "Shyqyri Bërxolli", Nr.1, i njohur personalisht prej meje, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, shtetas shqiptar dhe,

PRANUES DHURIMI: MIRJONA MAHO, e bija e Nevruzit, e datëlindjes 1973, banuese ne Tiranë, në të njëjtën adresë me bashkeshortin si më sipër, e njohur personalisht prej meje, madhore dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, shtetase shqiptare.

Z. PETRIT MAHO, si ortak i vetëm i Shoqërisë "JONA" - SH.P.K., regjistruar me cilësinë person juridik ne Zyren e "Regjistrimit Tregtar" te Gjykatës së rrethit te Tiranes me Vendimin Nr. 14613, date, 23.04.1996, eshte pronar i 100 (njëqind) perqind te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqërisë. Z. PETRIT MAHO më deklaroi se me vullnetin e tij te lire dhe te plote, 50 (Pesëdhjetë) perqind të kapitalit themeltar të Shqërisë, i barabartë me 50 (Pesëdhjetë) kuota, ia dhuron pa asnjë lloj shpërblimi bashkeshortes së tij, MIRJONA MAHO, te pavesuara nga ndonje lloj barre, hipoteke apo te mete tjeter te fshehur, duke e bërë ortakë me të drejta dhe detyrime të barabarta në këtë Shoqëri.

Zonja MIRJONA MAHO me deklaroi se e pranon pa asnjë pretendim dhurimin e kuotave të mësipërme të kapitalit themeltar të Shoqërisë "JONA" - SH.P.K. nga bashkeshorti i saj, ortak i vetëm i Shoqërisë, si dhe të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga pranimi i këtyre kuotave në Shoqërinë "JONAA" - SH.P.K.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate ne zyren e Noterise, Tirane, Z. PETRIT MAHO zhvishet nga pronesia per 50 (Pesëdhjetë) perqind të kapitalit themeltar të Shqërisë, i barabartë me 50 (Pesëdhjetë) kuota, ndersa Zonja MIRJONA MAHO behet pronare e ligjshme e ketyre kuotave te kapitalit themeltar te Shoqërisë se mesiperme, si dhe ortakë me te drejta dhe detyrime të barabarta në këtë Shoqëri.

Kjo kontrate u nxorr në katër ekzemplarë të barabartë dhe pasi u lexua nga palet dhe u pelqye nga e tyre, u nenshkrua me vullnet te lire dhe te plote ne pranime time, ndersa une, Noterja e vertetoj rregullisht sipas ligjit.

DHURUES:

PRANUES DHURIMI:

Petrith Maho
SH P K
JONA
TIRANE

Fatime Meta
FATIME META
Tel. 898 79
8000 22

Mirjona Maho
(Lalaci)